



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA BERAT

RELACION

PËR PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE TË  
MENJËHERSHME PËR RAST FATKEQËSIE PËR MJEKIM TË SPECIALIZUAR PËR Z  
GUXIM ÇILI

Të nderuar këshilltarë !


Në mbështetje të Ligjit nr.9936,datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndyshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimit Plotësues të MFE nr.4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” , si dhe bazuar në ligjin nr. 139/2016 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54 gërma dh, ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 4 pika 4, i drejtohem Këshillit Bashkiak me kërkesën për miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme në rast fatkeqësie z. Guxim Çili , me detyrë punonjës i Policisë Bashkiake për mjekim të specializuar, në bazë të dokumentacionit të paraqitur prej tij.

Polici bashkiak Guxim Çili, në datën 30 Prill 2021, gjatë ushtrimit të detyrës për ekzekutimin e një vendimi për nxjerrjen nga banesa e dhënë me qera nga Bashkia Berat të një qytetari për mospagesë të qerasë, është kundërshtuar dhe është goditur me mjete te ftohta nga qytetari. Nga ky sulm polici bashkiak ka pësuar dëmtime të rënda në dorën e majtë, e cila duhet t'i nënshtrohet ndërhyrjeve të specializuara .

Në keto rrethana propozojmë t'i jepet ndihma financiare në shumën 140,000 lekë, shumë e cila të përballohet nga Fondi Rezervë i Bashkisë për vitin 2021. Ky fond është miratuar me VKB nr. 81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”.

Ju faleminderit !

DREJTORIA E MENAXHIMIT FINANCIAR DHE TË ARDHURAVE

Rovena Shehu  




**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA BERAT**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**PROJEKTVENDIM**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT REZERVË PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE TË  
MENJËHERSHME PËR RAST FATKEQËSIE PËR MJEKIM TË SPECIALIZUAR PËR  
Z GUXIM ÇILI**

Këshilli i Bashkisë Berat pasi u njoh me materialin për “Për përdorimin e Fondit Rezervë Për dhënie ndihme financiare të menjëhershme për rast fatkeqësie për mjekim të specializuar për z Guxim Çili”, mbështetur në ligjin nr.9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin Plotësues të MFE nr.4 datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021”, si dhe bazuar në ligjin nr. 139/2016 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54, ligjin nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 4 pika 4”, ligjin nr 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, VKB nr. 81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2021 dhe PBA përfundimtare 2021-2023”, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Berat,

**V E N D O S I :**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës financiare të menjëhershme në rast fatkeqësie për mjekim të specializuar për z. Guxim Çili në shumën 140,000 lekë.
2. Shuma prej 140,000 lekë do të përballohet nga fondi rezervë i bashkisë miratuar për vitin 2021.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Menaxhimit Financiar dhe të Ardhurave.

**KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK**

**Ervin CECA**